



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

PKR.nr.50/23

MENDIM MOSPAJTUES

Trupi gjykues i Gjykatës Themelore në Pejë i përberë nga gjyqtaret: Violeta Husaj Rugova kryetare e Trupit Gjykues, Sami Sharaxhiu dhe Shaq Curri anëtar të trupit gjykues, në çështjen penale sipas aktakuzës së prokurores Themelore në Pejë PP/I.nr. 89/2018, me dt. 12.06.2019, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor të hapur për publikun, ka vendosur lidhur me këtë çështje me dt.15.03.2024.

Aktakuza e prokurorisë PP/I.nr. 89/2018, me dt. 12.06.2019, kundër Sh.G.për shkak të veprës penale, vrasje e rëndë nga neni 179 par. 1 nen par. 1.5 të KPRK-se, dhe vepër penale mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 te KPRK-se, kundër të akuzuarit I. C. për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 te KPRK-se.

Mendimi mospajtuës i kryetares së turpit gjykues Violeta Husaj Rugova qëndron lidhur me çështjen juridike dhe faktike lidhur me veprën e parë penale për të akuzuarit Sh. G., për të cilën shumica e turpit gjykues ka vlerësuar se duhet të shpallet fajtor për vepër penale vrasje nga pakujdesia nga neni 181 të KPRK-së.

1.Nuk pajtohem me vlerësimin e shumicës që në këtë çështje duhet të vendoset pa u lëshuar në vlerësimin e të gjitha provave në shkresë të lëndës të administruara gjatë rishqyrtimit gjyqësor dhe të merret vendim bazuar në veprimet procedurale të prokurorit në shqyrtimin e mëparshëm që rezultojnë me rikualifikim të veprës penale nga “vrasje e rëndë” në “vrasje nga pakujdesia” dhe të vlerësohen vetëm provat e administruara pas rihapjes së shqyrtimit gjyqësor me dt.19.03.2021. Trupi i njëjtë gjykues ka vendosur unanimitisht me aktgjykim PKR.nr.43/19 të dt.14.10.2022 ku është vendosur një herë në mënyrë të tillë. Mirëpo tashmë ky aktgjykim është i anuluar nga gjykata e Apelit ku dhe gjykata e Apelit ka aprovuar ankesën e prokurorisë dhe ka dhënë sugjerimet të cekura në aktvendimin PAKR nr.103/2023 të dt.23.03.2023.

2.Gjykata e Apelit në aktvendimin e lartcekur ka aprovuar ankesën e prokurorit dhe ka kthyer çështjen në rigjykim dhe ndër të tjera në faqen 6 pasuesi i 2 rreshti i 14 ka theksuar se:

“.....kolegji ka ardhur në përfundim se në këtë çështje penale gjykata e shkallës së parë nuk ka vlerësuar ekzistimin e veprës penale për të cilën e ka shpall fajtor të akuzuarin, si dhe rezulton se në masë të duhur nuk janë vlerësuar të gjitha provat të cilat janë pjesë përbërëse të kësaj lëndë për të gjetur përfundimin e rikualifikimit të veprës penale nga vepra penale e vrasjes së rëndë nga neni 179 par. 1 pika 1.5 të KPRK-së në veprën penale nga pakujdesia nga nei 181 të KPRK-së....”.

Pastaj në të njëjtën faqe në pasuesin e fundit rreshti i 3 gjykata e Apelit ndër të tjera thekson: *“...se cilët persona kanë qenë afër dhe a ka mundur tu rrezikohet jeta nga se nga shkresat e lëndës theksohet se A. H., A. T. dhe F. Z.j kanë qenë në një largësi në distancë prej 70 cm në mes veti, ndërsa në raport me të akuzuarit ka qenë distanca 4-5 m dhe nga kjo shkrepej goditet tani i ndjeri A. T.....”.*

Në faqe 7 pasusi i fundit ndër të tjera theksohet se: “.....gjykata e shkallës së parë në këtë çështje penale i ka vlerësuar në masë të duhur të gjitha provat të cilat i ka proceduar, mirëpo nuk ka vërtetuar se për cilën veprë penale është dashur që të shpallet fajtor i akuzuar Sh. G. dhe se të gjitha veprimet e ndërmarra gjatë hetimeve kanë pasur mbështetjen e duhur ligjore. Sa i përket kësaj çështje penale nga të gjitha provat personale si dhe ato material nuk mund të vërtetohet ekzistimi i veprës penal të vrasjes nga pakujdesia sikurse është pallur fajtor këtu i akuzuari.....”. si dhe shkelje të tjera.

Si përfundim gjykata e apelit konstaton se ka shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkelje të ligjit penale dhe vërtetim të gabuar të gjendjes faktike.

3.Obligimi ligjor i gjykatës së shkallës së parë për të vepruar sipas të gjitha sugjerimeve të Gjykatës së Apelit rezulton nga dispozita e nenit 406 par. 3 të KPRK-së e cila parasheh që: “gjykata themelore ndërmerr të gjitha veprimet procedurale dhe shqyrton të gjitha çështjet kontestuese të theksuara në vendimin e gjykatës së Apelit”. Nëse nuk do të rezultonte obligimi nga ky nen atëherë çështjet nuk do të mund të përfundonin dhe do të prolongoheshin, duke përshkruar rrugëtimin nga Gjykata Themelore në Gjykatë të Apelit dhe anasjelltas.

4. Bazuar në sugjerimet e Gjykatës së Apelit nuk pajtohem me mendimin e shumicës së trupit gjykues që kjo çështje të përfundoj pa një vlerësim të tërësisht të provave dhe vlerësimin faktik të çështjes, sepse përveç sugjerimeve të Gjykatës së Apelit në këtë çështje paraqiten edhe mospërputhje në mesë të vetë dispozitivave të aktgjykimit ku bëhet përshkrimin faktik i veprave penale që i vihen në barrë të akuzuarit Sh. G..

5.Dispozitivi i parë që ka të bëjë me vrasjen nga pakujdesia nga neni 181 të KPRK-së të cili shumica e trupit gjykues e mori për bazë, ka përshkrimin faktik me elementet e veprës penale që kërkohen sipas kësaj dispozite ligjore.

6.Dispozitivi i dytë që ka të bëjë me veprën penale mbajtja në pronësi kontroll posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së, në përshkrimin faktik nuk përmban fare pakujdesin.

7.Në dispozitivin e dytë ndër të tjera theksohet: “Me dt. 23. 09.2018, rreth orës 11:04 min, në D. në rrugën “ L. H. “ nr. ..., në Kompanin G. A., në kundërshtim me Ligjin për armët ka mbajtur ne posedim armën dhe atë revolen e tipit B., model, kalibër . mm, me numër serik B.....” pra në përshkrimin faktik nuk përmendet pakujdesia e as në kualifikimin juridik të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 te KPRK-se,

8.Këtë veprë ashtu të përshkruar e ka pranuar i akuzuari dhe gjykata i ka pranuar pranimin e fajësisë në fillim të rigjykimin.

9.Në dispozitivin e dytë në përshkrimin faktik nuk është shënuar as të paktën “ duke menduar se mbanë armën me gazë ka mbajtur armen B.”.

10.Prandaj, këtu shtrohet pyetja nëse armen në fjalë i akuzuari Sh. G. e mbajti me “dashje” dhe veprën penale të vrasjes e kreu nga “pakujdesia” sepse “nuk e diti çfarë arme kishte në dorë”? Që do të thotë se bien në kundërshtim vetë dispozitivët e aktgjykimit dhe gjykata pa një vlerësim të provave, nuk mund të eliminoj kundërthëniet në përshkrimin faktik të dispozitivit të aktgjykimit e kur pranohet fajësia nga ana e gjykatës, nuk mund të ndërhyj fare në dispozitiv-në përshkrimin faktik.

11.Çështje tjetër mospajtuese është se nuk pajtohem që kjo çështje të vendoset si “pakujdesi”. Nëse vërtetë gjykata do të vinte në përfundim se i akuzuari Sh. G. ditën kritike” ka menduar se ka marr armen me gazë”, atëherë do të vinte në pikëpyetje “lajthimi faktik” dhe në tërësi do të vinte në pikëpyetje ekzistimin e ndonjë vepre penale.

12.Bazuar në provat e administruara në rishqyrtim gjyqësor dhe shkeljet të konstatuara nga Gjykata e Apelit, nuk pajtohem se në këtë rast veprimet e të akuzuarit Sh. G. të ditës kritike që nga momenti i marrjes së armës e deri në përfundimin e veprës të kualifikohen si “pakujdesi”.

13.Çka thotë neni 23 i KPPRK-së për pakujdesin? Dispozitë kjo në pjesën së përgjithshme të Kodit Penal.

1. Vepra penale mund të kryhet me pakujdesi të vetëdijshme apo të pavetëdijshme.
2. Personi vepron me *pakujdesi të vetëdijshme* kur është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose të mosveprimit të tij, *por me mendjelehtësi mendon se ajo nuk do të shkaktohet apo se ai do të mund ta parandalojë shkaktimin e saj.*
3. Personi vepron *me pakujdesi të pavetëdijshme* kur nuk është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose mosveprimit të tij edhe pse në rrethanat dhe sipas vetive të tij personale ka mund të ishte apo do duhej të ishte i vetëdijshëm për këtë mundësi.

14. Bazuar në këtë dispozitë ligjore të cekur, shtrohet pyetja a ka menduar i akuzuari që mund ta shmang pasojën kur nxjerr armen repeton dhe shtënë në drejtim të punëtorit që ishte drejtpërdrejtë përballë tij? Cilat ishin ato veti personale që kishte i akuzuari që ai të mos kishte mundësi të parashikimit të pasojës? A kishte njohuri në përdorimin e armës? A ishte e lejuar mbajtja dhe përdorimi i armës, qoftë edhe asaj me gazë në vendin e punës ku ishte ai me punëtorët e tij? A mos i njëjti ishte në poligon të gjuajtjeve, në ndonjë depo të armëve, në gjueti apo edhe në ndonjë vende që fare të mos ketë mundur të parafytyroj që në një vend të tillë të ketë persona?

15.Përgjigjet e të gjitha këtyre pyetjeve mund konstatohen nëse vlerësohen të gjitha provat e administruara gjatë rishqyrtimit gjyqësor një nga një dhe në lidhje reciproke me njëra tjetrën , si deklaratat e dëshmitarëve, video incizimet, ekspertizat e administruara dhe ekspertët e dëgjuar. Duke marrë parasysh të lartcekurat, duke konsideruar se në rastin konkret duhet vepruar konform dispozitave ligjore dhe sipas çështjeve kontestuese të paraqitura nga Gjykata e Apelit, jap këtë mendim mospajtues.

Ky mendim mospajtues bazuar në nenit 368 par.1 të KPPRK-së i bashkëngjitet aktgjykimit.

Kryetarja e trupit gjykues

Violeta Husaj Rugova